

# AKT THEMELIMI DHE STATUTI

## ISHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “BEE SHOES”



Në Fier, sot në datë 10.12.2018 :

**Erald Filipi**, atesia Andrea, i/e datelindjes 01.11.1987, lindur e banues/e ne Fier shtetas/e shqiptar/e, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me karten/pasaporten nr. I71101068Q  
**Briken Colaj**, atesia Pal, i/e datelindjes 13.01.1984, lindur ne Aliaj, Shkoder e banues/e ne Patos, shtetas/e shqiptar/e, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me karten/pasaporten nr. I40113122P

me cilësinë e “ortakeve themelues” redaktuan këtë akt themelimi dhe statut, për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “BEE SHOES” sh.p.k. për sa vijon :

### Neni 1 Forma ligjore

Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjt nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjt nr. 131/2015 date 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Shoqëria do të drejtojë aktivitetin tregtar sipas legjisacionit shqiptar dhe dispozitave të dokumenteve të themelimit .

### Neni 2 Emërtimi

Emri i shoqërisë është “BEE SHOES” ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.p.k, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria “BEE SHOES” sh.p.k. do të ketë logon dhe vulën e saj, e cila aprovohet nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë .

### Neni 3 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- Zhvillimi i çdo lloj aktiviteti tregetar e prodhues te lejuar nga ligjet ne fuqi, transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe pasagjeresh , import-eksport, tregetim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshem industriale bujqesore, blegtore, ndertime, punime dhe germime dheu sistemime, tarracime terrenesh, murature me beton arme, sistemime, ndertime civile ekonomike, industriale turistike, bujqesore dhe kompletim me instalime e nevojshme per to ndertime ujesjelesa dhe kanalizime e impjante vaditje rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, investitore, vepra kulturore, rruge etj. import eksport linjash prodhimi te llojeve te ndryshme, paisje elektroshapike, elektrike hidrosanitare, mobilje, paisje zyrash, kancelari, konfeksione, fasoneri, prodhime farmaceutike, kozmetike, kimike te industrise se lehte import eksport te materialeve te ndertimit dhe tregtimi i tyre me shumice e pakice, ofrimi i sherbimeve te tekomunikacionit ne zonat rurale dhe urbane, ndertim rrjetesh telekomunikacioni sherbime interneti, sherbime ne vlere te shtuar etj.

Përshkrimi i objekteve të shoqërisë ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.

Shoqëria në çdo kohe mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të asamblesë së shoqërisë.

### Neni 4



## Selia

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën: ne lagjen "Apollonia", ndertesa nr. 3, rruga "Harilla Bozdo", Fier. Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas statutit te shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

## Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së shoqërisë.

## Neni 6 Regjistrimi i Kapitalit dhe Ortakët

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njeqindmije) leke, dhe është i perbere nga 2 kuota. Kapitali i shoqërisë zotërohet 100% nga 2 ortaket e shoqërisë, **Briken Colaj** i cili do te zoteroje **1 kuote me vlerë 55 000 leke (pesedhjete e pesemije) leke** dhe **Erald Filipi** do te zoteroje **1 kuote me vlerë 45 000 leke (dyzete e pesemije) leke**.

## Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.

Rritja e kapitalit mund të fillojë me emetimin e kuotave të reja ose duke rritur vlerën e kuotave ekzistuese.

Zvogëlimi i kapitalit do të autorizohet nga vendimi i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.

Drafti për zvogëlimin e kapitalit do tu komunikohet ekspertëve kontabël të licencuar, të paktën 45 ditë para procedimit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, e cila do të mblidhet në mënyrë specifike për të vendosur këtë draft. Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të marrë këtë vendim bazuar mbi raportin e ekspertit kontabël.

Të gjitha procedurat për zvogëlimin e kapitalit do të kryhen në përpunje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".


## Neni 8 Organet Drejtuese

1. Asambleja e Ortakëve,
2. Administratori.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit prej organeve të shoqërisë janë të parashikuara më gjërësisht në vijim.

## Neni 9 Asambleja e përgjithshme

1. Të drejtat e ortakëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme e përbërë nga ortakët e saj.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshime të statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin, revokimin e administratorit;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;



- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
  - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Pavarësisht nëse shoqëria zotërohet nga një apo shumë ortakë, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga çdo ortak. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

**Neni 10**  
**Administratori**

Emërimi i Administratorit të shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme. Administrator i shoqërisë për një afat prej 5 (pesë) vjet dhe me të drejtë riemërimi do të jetë:

- **Briken Colaj**, atesia Pal, i/e datelindjes 13.01.1984, lindur ne Aliaj, Shkoder e banues/e ne Patos, shtetas/e shqiptar/e, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i nr. I40113122P
- Administratori ka këto kompetencia :
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë ;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare ;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
  - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) të kryejë regjistimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - e) të raportojë përpara asamblesë për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**Neni 11**  
**Auditimi Financiar**

Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme emëron ekspert të certifikuar kontabël si auditor të pavarur për periudhën e përcaktuar me ligj. Auditori i pavarur do të jetë i emëruar për një periudhë të pacaktuar.

Shoqëria ka të drejtën të emërojë një ose me shumë auditorë.

Auditorët e pavarur do të kenë të drejtën për të analizuar të gjitha rastet e devijimit të procedurave ligjore fiskale të kryera nga ortakët, në mënyrën e përcaktuar në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 12**  
**Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar**

Viti finanziar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht, viti i parë finanziar do të fillojë në datën kur shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti finanziar, Administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, do tu kalojë ortakëve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë ose mund të kalojë për investime me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Mbledhje e Zakonshme).

Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh përvëç fondeve të parashikuara në nenin e mësipërm.

### **Neni 13 Prishja e Shoqërisë**

Shoqëria prishet:

- a) Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) Me hapjen e një procedure falimentimi;
- c) Nëse nuk ka kryer aktivitet tregtarë për periudhën e përcaktuar në ligj;
- d) Me vendim të Gjykatës .

### **Neni 14 Likuidimi i Shoqërisë**

Përvëç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim, kur miraton një vendim me këtë objekt të propozuar nga administratori.

Për këtë qëllim, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, emëron një a më tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

### **Neni 15 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Të gjitha çështjet që nuk gjejnë një rregullim të posaçëm në këtë akt themelimi dhe statut, në marrëveshje me palët, do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil në fuqi apo nga dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në fuqi si dhe Ligjit “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontablit të miratuar”.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të këtij akt themelimi dhe statuti si dhe midis ortakëve të shoqërisë, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier .

### **Neni 16 Dispozita të Fundit**

Ky akt themelimi dhe statut është redaktuar nga ortaket e shoqërisë në 4 (katër) ekzemplarë me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

Balkan Obez  
Kosova 198

Erald Filipi  
~~E. Filipi~~



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE VLORE  
Nr. 3534 Rep.

**N O T E R**  
**GENTIAN MIÇO**

e-mail micogenti@yahoo.com

cel. 069 68 42 645

### **VERTETIM NENSHKRIMI**

Ne Fier, sot me 10. 12. 2018, perpara meje noterit Gentian Rapi Miço, anetar i Dhomes se Noterise Vlore, u paraqiten personalisht shtetasit e meposhtem :

- ♦ **Briken Colaj**, atesia Pal, i/e datelindjes 13.01.1984, lindur ne Aliaj, Shkoder e banues/e ne Patos, shtetas/e shqiptar/e, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me karten/pasaporten nr. I40113122P
- ♦ **Erald Filipi**, atesia Andrea, i/e datelindjes 01.11.1987, lindur e banues/e ne Fier shtetas/e shqiptar/e, me zotesi te plete per te vepruar, identifikuar me karten/pasaporten nr. I71101068Q

te cilet nenshkruan ne pranine time noterit, statutin dhe aktin e themelimit per shoqerine “BEE SHOES” sh.p.k. , dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit .

**NO T E R**